

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 202/2020

në lidhje me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë për lëndën
C.nr. 307/2019

Drejtuar: Znj. Albina Shabani-Rama, kryetare
Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, më 30 nëntor 2023

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP), lidhur me nevojën e ndërmarjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C. nr. 307/2019, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. [Emri i ankuesit] (në tekstin e mëtejshëm: *ankuesi*) dhe mbështetet në faktet dhe në provat e ankuesit dhe në shkresat e lëndës, të cilat i posedon Avokati i Popullit, lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën C. nr. 307/2019. Çështja ka të bëjë me anulimin e vendimit të Komisionit Përzgjedhës për Menaxhimin e Procesit të Rekrutimit dhe Seleksionimit për Zyrtarë Policorë në Policinë e Kosovës, bazuar në konkursin e shpallur.

Baza ligjore

3. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
4. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 8, përcakton: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave.”*

Përmbledhje e fakteve

5. Policia e Kosovës (PK) kishte shpallur konkurs për zyrtarë policorë, i cili kishte qenë i hapur nga data 16 prill deri më 10 maj 2018. Ankuesi ka pohuar se kishte aplikuar dhe u ishte nënshtruar të gjitha procedurave për përzgjedhje, të cilat me sukses i kishte përfunduar, ndërsa sipas njoftimit të Policisë, kontrollin mjekësor nuk e kishte kaluar dhe rrjedhimisht nuk ishte përzgjedhur. Më tutje ankuesi ka pohuar se kishte parashtruar ankesë në Komisionin Përzgjedhës për Menaxhimin e Procesit të Rekrutimit dhe Seleksionimit për Zyrtarë Policorë kundër njoftimit të PK-së, duke i bashkëngjitur edhe dokumente të reja mjekësore që vërtetonin se ai ishte plotësisht i shëndetshëm, por ankesa i ishte refuzuar me vendim.
6. Më 6 shkurt 2019, ankuesi kishte parashtruar Padi C.nr. 307/19 në GjThP, përmes së cilës kishte kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit Përzgjedhës për Menaxhimin e Procesit të Rekrutimit dhe Seleksionimit për Zyrtarë Policorë në PK, sipas konkursit, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.
7. Më 12 shkurt 2019, GjThP-ja kishte nxjerrë aktvendim me të cilin e kishte refuzuar propozimin e ankuesit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.
8. Më 10 prill 2019, ankuesi kishte parashtruar në GjThP urgjencë për caktimin e seancës, por deri më tani, sipas tij, gjykata nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta proceduar rastin.
9. Më 27 shkurt 2020, ankuesi kishte paraqitur ankesë te Avokati i Popullit lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore nga GjThP-ja, për shqyrtimin e lëndës C. nr. 307/2019.
10. Më 8 qershor 2020, Avokati i Popullit i kishte dërguar shkresë kryetares së GjThP-së, për të kërkuar informata lidhur me fazën në të cilën ndodhej procedura në çështjen e ankuesit dhe veprimet që ishin ndërmarrë apo që planifikoheshin të ndërmerreshin nga

gjykata, ashtu që ky rast të procedohej brenda afatit kohor, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

11. Më 26 qershor 2020, gjyqtari i lëndës përmes shkresës e kishte njoftuar Avokatin e Popullit se më 12 shkurt 2019 kishte marrë aktvendim lidhur me kërkesën për masë të përkohshme të sigurisë, ndërkaq lidhur me kërkesëpadinë planifikonte që brenda muajit korrik të vitit 2020 të vendoste në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.
12. Më 29 qershor 2020, zyra e Avokatit të Popullit e kishte njoftuar ankuesin për përgjigjen e gjykatës. Ndërsa më 17 nëntor 2020, zyra e Avokatit të Popullit ishte njoftuar nga ankuesi se gjykata ende nuk kishte vendosur për rastin e tij.
13. Më 29 dhjetor 2020, më 22 shtator 2021, më 19 prill 2022,¹ Avokati i Popullit i kishte dërguar shkresa përsëritëse kryetares së GjThP-së, për të kërkuar informata lidhur me veprimet procedurale që ishin ndërmarrë apo që planifikoheshin të ndërmerreshin nga gjykata, lidhur me lëndën C.nr. 307/2019.
14. Më 3 nëntor 2021, më 10 maj 2022, Avokati i Popullit kishte marrë përgjigje² nga kryetarja e GjThP-së, me të cilat ishte njoftuar se lënda i ishte caktuar gjyqtares e cila aktualisht ishte duke i trajtuar lëndët më të vjetra të natyrës së njëjtë dhe se lënda do të procedohej brenda një afati të arsyeshëm kohor, në pajtim me dispozitat ligjore, strategjinë për kryerjen e lëndëve dhe planifikimet e gjykatës.
15. Më 8 mars 2023, Avokati i Popullit përsëri i kishte dërguar shkresë kryetares së GjThP-së, për të kërkuar informata lidhur me fazën në të cilën ndodhej procedura në çështjen e ankuesit dhe për veprimet që ishin ndërmarrë apo që planifikoheshin të ndërmerreshin nga gjykata.
16. Më 22 mars 2023, Avokati i Popullit kishte marrë përgjigje nga kryetarja e GjThP-së, me të cilën ishte informuar se gjykata kishte filluar të procedonte me lëndën në drejtim të krijimit të kushteve për caktimin e seancës gjyqësore, ashtu që më 14 mars 2023, me Aktvendimin C.nr.307/2019, padia së bashku me shkresat e tjera të lëndës i ishin dërguar palës së paditur për përgjigje në padi dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata do të procedonte tutje me lëndën.
17. Më 19 korrik 2023, ankuesi e kishte informuar Zyrën e Avokatit të Popullit se GjThP-ja ende nuk kishte caktuar seancë në rastin e tij.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

18. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton: “*Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...].*”
19. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përcaktohet me nenin 31.1 të Kushtetutës: “*Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*”

¹ Shih: Shkresa Nr. 2066/2020, dërguar më 29 dhjetor 2020; Shkresa Nr. 1452/2021, dërguar më 22 shtator 2021; Shkresa Nr. 646/2022, dërguar më 19 prill 2022.

² Shih: Shkresa Nr.454/2021, pranuar më 3 nëntor 2021; Shkresa Nr.177/2022, pranuar më 10 maj 2022; Shkresa Nr. 151/2023, pranuar më 22 mars 2023.

20. Po ashtu, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e përcaktuar me nenin 54 të Kushtetutës, parasheh:

“Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

21. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj), sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës është dokument ligjor drejtpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.³ Ndërsa paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNj-së garanton:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.”

22. Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, në nenin 7, paragrafi 2, përcakton:

“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë, në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.”

23. Ndërsa neni 7, paragrafi 5, i Ligjit për Gjykatat përcakton:

“Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.”

24. Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në nenin 475, përcakton:

“Kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.”

Analiza ligjore

25. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit të drejtat dhe liritë e njeriut interpretohen në harmoni me vendimet e praktikave të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

26. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që për çështjen e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

27. Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

28. Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-ja ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohe të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

29. Në rastin në fjalë, Avokati i Popullit rithekson se periudha përkatëse për t'u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej datës 6 shkurt 2019, datë kjo kur paditësi kishte paraqitur padinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
30. Njëkohësisht, mungesa e mjeteve efektive në shkeljen e së drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, siç është e garantuar me nenin 6 të KEDNj-së, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili thotë:
- “Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.”*
31. Për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih Aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).
32. Neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht t'i mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë, për një individ, që e bën të mundur që ai/ajo t'i gëzojë të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtojë këtë ankesë te një autoritet vendor. Kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih Aktgjykimin *Kudla kundër Polonisë*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv te një autoritet vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Pasi rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
33. Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).
34. Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës gjyqësore, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të kishin qenë në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar apo mosvazhdimin e saj, ose të ofronin përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).

35. Në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor, përmes së cilit ankuesi do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo të kompensimit.
36. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kishte nxjerrë një numër aktgjykimesh ku kishte konstatuar shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke i shtjelluar parimet e përgjithshme të praktikës së saj gjyqësore dhe të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke aplikuar të njëjtat në rrethanat e rasteve që janë ngritur për vlerësim. Gjykata Kushtetuese, sipas këtyre parimeve, kishte vlerësuar se përlllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje, me kërkesë të palëve, për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar, dhe vazhdon deri në nxjerrjen dhe zbatimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit. Ndërsa arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, bazuar në: (i) ndërlikueshmërinë e rastit; (ii) sjelljen e palëve në procedurë; (iii) sjelljen e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest (shih rastet KI06/21, Dragan Mihajloviq, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së procedurave në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, përkitazi me lëndën Ac. nr. 3930/2016, i datës 22 dhjetor 2022; KI177/19, parashtrues NNT "Sokoli", Aktgjykim i 16 prillit 2019, paragrafët 96-106; KI19//21, parashtrues Sadik Pllana, Aktgjykim i 11 gushtit 2022, paragrafi 85).

Konstatimet e Avokatit të Popullit

37. Zvarritjet e procedurës gjyqësore shkaktojnë pasoja serioze në sundimin e ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Zvarritja e rastit gjyqësor në fjalë, e cila sipas praktikës së GjEDNj-së fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë, që në rastin konkret është data 6 shkurt 2019, pa vendim përfundimtar, shkel:

- *Të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të përcaktuar dhe të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së.*
- *Të drejtën për mjete efektive juridike të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së.*
- *Të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*

Duke u bazuar nga të cekurat më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: "[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore."; dhe me nenin 16, paragrafi 8, të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit: "Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës."; bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e

rekomanduesit, duke u referuar në argumentet e lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës, i


REKOMANDON

Gjykatën Themelore në Prishtinë

- Pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C. nr. 307/19.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,



Naïm Qelaj
Avokat i Popullit